

Burime shtesë

Vaksinohuni!

- **Vaksinat kundër COVID-19 shpëtojnë jetë.** Kur vaksinoheni, ndihmoni në mbrojtjen e vetes nga COVID-19 dhe sigurimin e komunitetit tuaj. Nëse keni pasur COVID-19, është prapë e rëndësishme që të vaksinoheni. Duhet të prisni derisa të shëroheni nga COVID-19 dhe të keni përfunduar izolimin për të shmangur ekspozimin e të tjerëve në pikën e vaksinimit ndërsa mund të jeni ende ngjitës. Të gjithë njerëzit që banojnë, punojnë apo studiojnë në qytetin e Nju-Jorkut përfitojnë nga vaksinimi në qytetin e Nju-Jorkut, me disa kufizime për moshën. Vizitoni **nyc.gov/vaccinefinder** ose telefononi në nr. **877-VAX-4NYC (877-829-4692)** për të gjetur një pikë.
- **A dëshironi ta bëni në shtëpi vaksinën kundër COVID-19?** Ne mund të planifikojmë sot një vaksinë kundër COVID-19 në shtëpi për ju dhe këdo tjetër në shtëpinë tuaj të moshave nga 12 vjeç e lart. Na telefononi në nr. **212-242-2692** dhe shtypni **3**.
- **Njujorkezët mund të përfitojnë gjithashtu bileta falas, anëtarësi dhe dhurata për vaksinimin kundër COVID-19.** Këto dhurata do të ofrohen për një afat të kufizuar. Mësoni më shumë te **nyc.gov/vaccineincentives**



Leje e paguar për vaksinim

- Njujorkezët mund të marrin deri në katër orë leje të paguar për çdo dozë vaksine, katër orë gjithsej për vaksinat me një dozë ose tetë orë gjithsej për vaksinat me dy doza. Kjo leje paguhet me normën e zakonshme të pagesës së punëmarrësit dhe nuk mund të hiqet nga ndonjë leje tjetër. Nëse ndjeni efekte anësore nga vaksinimi juaj, për t'u shëruar mund të përdorni lejen e grumbulluar për raste sëmurjeje.



AfterCare


- Vizitoni uebfaqen AfterCare të Take Care në **nyc.gov/aftercare** nëse keni ende simptoma që lidhen me COVID-19 në javët apo muajt pas periudhës suaj të veçimit dhe nëse kërkon mbështetje për nevojat shëndetësore dhe shoqërore.

Qendrat e ekselencës të COVID-19

- Aktualisht NYC Health + Hospitals ka Qendra Shëndetësore Komunitare të dedikuara për ata që shërohen nga COVID-19 dhe ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh për t'i mbajtur nju-jorkezët të shëndetshëm. Mësoni më shumë te **nyc.gov/aftercare** ose telefononi në nr. **212-COVID19 (212-268-4319)** dhe shtypni **0**.

Trajtimi i COVID-19

- **A ka trajtime për COVID-19?**
 - » **Po!** Për personat me probleme të caktuara shëndetësore, trajtimi me antitropa monoklonale është i sigurt dhe efikas në parandalimin



e shtrimit spitalor. Ky trajtim është falas përmes NYC Health + Hospitals, edhe nëse nuk keni sigurim.

■ Çfarë janë antitruapat monoklonalë?

- » Kur sëmureni, trupi juaj krijon antitruapa për të luftuar infeksionin. Antitruapat monoklonalë imitojnë reagimin e natyrshëm të trupit tuaj ndaj luftimit të një infeksioni. Trajtimi funksionon më mirë sapo të ndiheni të sëmurë, ndaj na telefononi sot!

■ A përfitoj trajtim?

- » Antitruapat monoklonalë funksionojnë më mirë te njerëzit që kanë simptoma të COVID-19 dhe kanë probleme të caktuara mjekësore. Ju përfitoni trajtimin nëse:
 - Keni test pozitiv për COVID-19
 - Keni simptoma të COVID-19 që janë të lehta deri mesatare
 - Peshoni të paktën 88 lb (40kg)
 - Ju jeni:
 - 65 vjeç e lart
 - 12 vjeç e lart dhe keni rrezik të lartë të zhvillimit të një sëmundjeje të rëndë. Problemet e rrezikut të lartë përfshijnë, mes të tjerash, sëmundjen e zemrës, sëmundjen e mushkërisë, sëmundjen e veshkave, shtatzëninë, të qenit mbipeshë ose obez, diabetin, problemet imunokompromentuese, sëmundjen e qelizave drapër dhe problemet e zhvillimit mendor. Kontaktoni një profesionist mjekësor për të diskutuar nëse ky është trajtimi i duhur për ju.



■ Si të regjistrohem për trajtim?

- » Për t'u lidhur me një profesionist mjekësor, telefononi në nr. **212-COVID19 (212-268-4319)** ose **covid19.nychealthandhospitals.org/mab**

Programi i asistencës me qira në rast emergjence

- Njujorkezët në familje me të ardhura të ulëta ose të mesme mund të marrin deri në 12 muaj qira të prapambetur, 3 muaj qira të ardhshme dhe asistencë me shërbimet komunale nëse kanë mbetur pas me qiranë që nga marsi 2020. Për më shumë informacion dhe për të aplikuar, shkoni te **nyc.gov/erap** ose na bëni një telefonatë në nr. **212-242-2692** dhe shtypni **3**.

Fondi i punëtorëve të përjashtuar

- Njujorkezët mund të marrin deri në \$15,600 asistencë të drejtpërdrejtë me para në dorë nëse nuk kualifikohen për përfitime të papunësisë ose të asistencës federale me të ardhura në lidhje me COVID-19 për shkak të statusit të tyre të imigrimit ose faktorëve të tjerë. Për të mësuar nëse përfitoni dhe për më shumë informacion, vizitoni **access.nyc.gov/excluded-workers-fund**